Kronikë

Mbante në banesë armë e municion luftarak, arrestohet 29-vjeçari në Laç

I riu u kap në flagrancë teksa gjatë kontrolleve policore me qëllim parandalimin e ngjarjeve kriminale, iu gjet në banesë dhe iu sekuestrua 1 armë zjarri automatik me krehër dhe fishekë dhe 1 palë doreza.

Redaksia
1 Janar, 10:20 | **Përditësimi: 1 Janar, 10:25**

Share

Një 29-vjeçar është arrestuar nga policia në qytetin e Laçit i akuzuar për armëmbajtje pa leje.

I riu me iniciale S. K., u kap në flagrancë teksa gjatë kontrolleve policore me qëllim parandalimin e ngjarjeve kriminale, iu gjet në banesë dhe iu sekuestrua 1 armë zjarri automatik me krehër dhe fishekë dhe 1 palë doreza.

29-vjeçari me iniciale S. K., akuzohet për veprat penale "Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyese dhe i municionit", ndërsa sendet e kundërligjshme u sekuestruan me cilësinë e provës materiale.

LEXO EDHE:
Lezhë/ Kthyen godinën 3 katëshe në kazino, arrestohet përgjegjësi, shpallet në kërkim 24-vjeçari, 15 të tjerë nën hetim! Sekuestrohet drogë e miliona lekë

"*Kurbin/Finalizohet operacioni policor i koduar "Fokusi". Goditet një tjetër rast i mbajtjes pa leje, të armës së zjarrit.*

Sekuestrohet 1 armë zjarri automatik me krehër dhe fishekë.

Arrestohet shtetasi që e mbante armën, pa leje, në Laç.

Si rezultat i punës së mirorganizuar informative dhe operacionale, të intensifikuar gjatë ditëve festive të fundvitit, me objektiva parandalimin e ngjarjeve kriminale, si dhe garantimin e rendit dhe qetësisë, shërbimet e Komisariatit të Policisë Kurbin finalizuan operacionin "Fokusi".

Gjatë operacionit, bazuar në informacionet e siguruara në rrugë operative, u ndërhy menjëherë në banesën e shtetasit S. K., 29 vjeç, në lagjen nr. 4, Laç, ku nga kontrolli u gjet 1 armë zjarri automatik me krehër dhe fishekë, e cila posedohej pa leje, si dhe një palë doreza.

Në vijim të veprimeve procedurale mbi rastin, 29-vjeçari u arrestua në flagrancë, për veprën penale "Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyese dhe i municionit", ndërsa sendet e kundërligjshme u sekuestruan me cilësinë e provës materiale.

Materialet procedurale iu referuan Prokurorisë së Lezhës, për veprime të mëtejshme", njofton policia.

K.B/E.H/Shqiptarja.com

TAG: Lezhe Kurbin armembajtje pa leje

Komento

Komente

Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

Sondazhi i ditës:
Çfarë prisni nga Viti i Ri 2026?

1 Janar, 11:12

Shëndet Mirëqenie Punë

Lajme të tjera

Qytetarët në Lezhë sfidojnë temperaturat e ulëta, festë e magji fishekzjarresh për ardhjen e 2026-ës (VIDEO)
1 Janar, 00:20

Drama 'epoka e robotëve' ngjitet në skenën e Lezhës
31 Dhjetor 2025, 15:36

Qeveria miratoi dje shpërblimin 15 mijë lekë për fundvit, personat me aftësi të kufizuara në Lezhë protestojnë për paratë e pamarra
31 Dhjetor 2025, 12:41

Lëvizte i dehur me kallashnikov duke kërcënuar qytetarët rrugës, arrestohet 28-vjeçari në Kurbin! Me qytën e armës theu xhamat e 3 mjeteve dhe të 1 lokali
31 Dhjetor 2025, 11:08

Lezha përkujton At Gjergj Fishtën, organizon veprimtari kulturore në 85-vjetorin e ndarjes nga jeta të poetit mbarëkombëtar
31 Dhjetor 2025, 11:04



Korçë/ Arrestohet në lokal 31-vjeçar me armë zjarri, tentoi t'i ikë policit me vrap! Me precedent penal, në 2017 qëlloi me kallashnikov drejt një lokali nate (EMRI+VIDEO)
31 Dhjetor 2025, 09:43

Pas 3 muajsh punime, hapet ura e Cenit në Lezhë, kryebashkiaku: Një nga investimet më të rëndësishme që kemi bërë deri më tani (VIDEO)
Elvis Hila
29 Dhjetor 2025, 10:34

I dënuar që prej 2021 për 'dhunë në familje', ndërron jetë në burgun e Lezhës 50-vjeçari! Merrte mjekim të detyruar
29 Dhjetor 2025, 09:28

Mirdita në festë! Këndi i festave në Rrëshen tërheq qytetarë dhe vizitorë
Elvis Hila
27 Dhjetor 2025, 10:23

Lezhë/ Siguria rrugore gjatë dimrit, Prefekti Malshi kërkon monitorim të rreptë të firmave të mirëmbajtjes dhe ndërhyrje në nyjet problematike
26 Dhjetor 2025, 10:43

Shkodër/ Në kërkim për drogë dhe armëmbajtje pa leje, pranga 25-vjeçari! Në kërkim një tjetër (EMRI)
25 Dhjetor 2025, 10:30

Besimtarët në Lezhë kremtojnë Krishtlindjen në Katedralen e Shën Nikollit
25 Dhjetor 2025, 09:45

RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com

© 2011 - 2026 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje